



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 06.12.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Medi Bici | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Naureda Llagami*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

2. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Maksim Qoku: Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Në vijim të mbledhjeve emergjente që po bëjmë në kuadër të emergjencave për efektin e funksionimit të gjykatave, sot kemi një rend dite me dy pika.

Pika e parë është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës” dhe, pika e dytë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm të selisë dhe rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Atëherë, në lidhje me pikën e parë, në komunikimin që kemi pasur me kryetaren e gjykatës, znj. {...}, na ka ardhur akti i konstatimit i Institutit të Ndërtimit i datës 05.12.2019, i cili në fund konkludon që objekti aktualisht është i banueshëm, çka do të thotë, në vazhden e vendimmarrjeve të mëparshme, kemi marrë edhe projektvendimin në lidhje me rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në datën 06.12.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse keni gjë për të shtuar... Nëse, për ndryshe kalojmë në votim.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Pro.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 06.12.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 2. Medi Bici*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ilir Toska*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)
- 8. Brikena Ukperaj*** (anëtar)
- 9. Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Naureda Llagami.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

2. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Maksim Qoku: Okej atëherë, kalojmë në çështjen e dytë, në lidhje me projektvendimin “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës dhe transferimin e përkohshëm të selisë së Gjykatës së Apelit Durrës pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Duke qenë që tashmë jemi në dijeni që Gjykata e Apelit Durrës është në pamundësi për ushtrimin e një aktiviteti normal. Në biseda që kemi ushtruar edhe me kryetarin e kësaj gjykate dhe në çmuarjen edhe të akt kontrolleve (akt konstatimit) kemi hartuar një projektvendim në lidhje me faktin e transferimit të kësaj gjykate në godinën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe rifillimin e aktivitetit dhe shërbimeve gjyqësore.

Ta lexoj projektvendimin?

Atëherë, projektvendim “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës dhe transferimin e përkohshëm të selisë së gjykatës pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë” – Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

2. Transferimin e përkohshëm të selisë pranë kësaj godine... *(ka një lapsus, më poshtë riformulohet e saktë fjalia)* 3. Kryetari i Gjykatës së Apelit Durrës dhe kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë të marrin masa për krijimin e kushteve të duhura në zbatim të pikës 1. 4. Kryetarët e gjykatave nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës, në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, të dërgojnë dosjet gjyqësore në selinë e re të përkohshme të Gjykatës së Apelit Durrës si dhe ashtu të marrin masa për të garantuar aksesin në gjykatë, duke informuar publikun për transferimin e përkohshëm të selisë së Gjykatës së Apelit Durrës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse keni për të diskutuar apo sqaruar, ose kalojmë në votim.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, përfundimisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës. 2. Transferimin e përkohshëm të selisë të kësaj gjykate pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë. 3. Kryetari i Gjykatës së Apelit Durrës dhe kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë të marrin masa për krijimin e kushteve të duhura në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi *(lapsus, pasi duhet “në zbatim të pikës 2 të këtij vendimi”)*. 4. Kryetarët e gjykatave nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës, në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi *(lapsus, pasi duhet “në zbatim të pikës 2 të këtij vendimi”)*, të dërgojnë dosjet gjyqësore në selinë e re të përkohshme të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe të

marrin masa për të garantuar aksesin në gjykatë duke informuar publikun për transferimin e përkohshëm të selisë së Gjykatës së Apelit Durrës. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse nuk kemi gjë tjetër.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Mirupafshim!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor